



Prishtinë, 23 qershor 2016
Kodi i ZRRE-së: V_824_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
 - Nenin 4, nenin 5, nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 14, nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja;
 - Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
 - Nenin 4, nenin 8, nenin 11 dhe nenin 12 të Rregullën për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-810-2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin "Wind Park - KITKA", me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, komuna e Kamenicës, të datës 25.09.2013 të shoqërisë "Air - Energy" SH.P.K., me adresë "Isa Boletini", p.n. Komuna Gjilan, Republika e Kosovës;
 - Vendimin nr. V-604-2013 të dt. 27 dhjetor 2013 për lëshimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për shoqërinë "Air - Energy" SH.P.K., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin "Wind Park-KITKA", komuna e Kamenicës.
 - Vendimi V-684-2015 i datës 20 shkurt 2015 për Pranim në Skemën Mbështetëse;
 - Vendimin nr. 765-2016 të dt. 28 janar 2016 për shtyerjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-604-2013 të datës 27 dhjetor 2013.
 - Kërkesën/aplikacionin nr. prot. Nr.303/16 dt. 06.06.2016 për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin "Wind Park - KITKA", me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW komuna e Kamenicës, të datës 25.09.2013 të shoqërisë "Air - Energy" SH.P.K., me adresë "Isa Boletini", p.n. Komuna Gjilan, Republika e Kosovës, dhe
 - Kontratat, lejet, pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në shtojcën II. të këtij vendimi,



në seancën e mbajtur me datë 23 qershor 2016 nxori këtë:

V E N D I M PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT FINAL

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI FINAL** shoqërisë **“Air - Energy” SH.P.K.**, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin **“Wind Park - KITKA”**, për vendosjen e 9 (nëntë) turbinave secila veç e veç me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW dhe 1 (një) turbinë me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, dhe totali i kapacitetit të instaluar prej **32.4 MW**, në ZK Hogosht, Poličkë dhe Velegllavë e Epërmeve Komuna e Kamenicës, i pajisur edhe me Lejen e Ndërtimit nr. K.III-01/2016 datë. 19.05.2016 të lëshuar nga MMPH.
- II. Vendimi për Autorizim i lëshohet shoqërisë **“Air - Energy” SH.P.K.**, për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe, të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar, nga data e lëshimi të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- IV. Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën III. të këtij vendimi, shoqëria **“Air – Energy” sh.p.k.**, do të lidh Marrëveshjen për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditë para datës së fillimit të operimit gjenerues me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V-810-2016 dt. 19 maj 2016 të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.
- V. Shoqëria **“Air - Energy” SH.P.K.**, obligohet që para se të futet në operim (prodhim) të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 25.09.2013 nga ndërmarrja **““Air - Energy” SH.P.K.**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, në lokacionin **“Wind Park - KITKA”**, komuna e Kamenicës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga ERA, me datë 27 dhjetor 2013 ka Lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-604-2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.



- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat dy (2) vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë “Air - Energy” SH.P.K., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim, për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- ZRRE me datë 22.01.2015 nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për pranim në Skemën Mbështetëse.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 20 shkurt 2016 nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., i ka lëshuar Vendimin V-684-2015 për pranimin e operatorit gjenerues në Skemën Mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin “Wind Park - KITKA”, me kapacitet të instaluar prej 32.5 MW, komuna e Kamenicës, Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 07.12.2015 ka pranuar nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V-604-2013 të datës 27 dhjetor 2013, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- ZRRE me datë 28 janar 2015 ka lëshuar vendimin nr. 765-2016 të dt. 6 për shtyerjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V-604-2013 të datës 27 dhjetor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **27 qershor 2016**.
- ZRRE me datë 06.06.2016 nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin “Wind Park - KITKA”, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW komuna e Kamenicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga MMPH dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: në bazë të studimeve të fundit dhe matjeve të erës në lartësi 82 m për gjatë një viti, me sugjerimin e prodhuesit të turbinave më adekuate, më fizibël dhe më racionale në prodhim të energjisë elektrike janë turbinat me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW, mirëpo të kushtëzuar nga Leja e Ndërtimit e lëshuar nga MMPH, që mos të kalohet Autorizimi Preliminar për kapacitetin 32.5 MW, ka kërkuar nga ZRRE, që ti mundësohet shëndërrimi i Autorizimit Preliminar në Autorizim Final për ndërtim për kapacitetin e instaluar prej 32.4 MW, dhe atë për 9 (nëntë) turbina me nga 3.3 MW secila veç e veç dhe 1 (një) turbinë me kapacitet 2.7 MW, ku totali i instaluar është **32.4 MW**, pasi që kushtet teknike të prodhimit të turbinave kanë ndikuar që kapaciteti të jetë 32.4 MW, që mos të tejkalohet në asnjë situatë Leja e Ndërtimit dhe Autorizimi Preliminar i lëshuar nga ZRRE për kapacitetin e instaluar prej 32.5 MW.





- ZRRE, pas vlerësimit të dëshmimeve të bashkangjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkangjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar,


Arsim Janova, anëtar,


Qemaj Mustafa anëtar,


Besim Sejfiqaj anëtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kamenicës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



SHTOJCA I

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e kapaciteteve të reja, shoqërisë "Air - Energy" SH.P.K., me adresë "Isa Boletini", p.n. Komuna Gjilan, Republika e Kosovës, me datë **23 qershor 2016**, i lëshon këtë:

AUTORIZIM

- Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin "Wind Park - KITKA", për vendosjen e 9 (nëntë) turbinave secila veç e veç me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW dhe 1 (një) turbinë me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, dhe totali i kapacitetit të instaluar prej 32.4 MW, në ZK Hogosht, Poliçkë dhe Velegllavë e Epërmeve Komuna e Kamenicës, dhe sipas Lejes së Ndërtimit nr. K.III-01/2016 datë 19.05.2016 të lëshuar nga MMPH.**
- Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria "Air - Energy" SH.P.K., që të ndërtojë kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
- Ky Autorizim lëshohet për dy (2) vite, duke filluar nga data e lëshimit të tij. ZRRE me kërkesë të palës, mund ta vazhdojë vlefshmërinë e Autorizimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
 - të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
 - të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
- Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat e nenit 19 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të Autorizuar, duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- Vlefshmëria e këtij Autorizimi automatikisht do të përfundojë me skadimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin nën II. të këtij Vendimi, apo me skadimin e afatit shtesë të përcaktuara nga ZRRE në përputhje me pikën 3 të shtojcës I. të këtij Autorizimi.
- Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjëres prej kushteve të këtij Autorizimi, dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE, do ta pezullojë këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar, mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.



9. Pala e autorizuar duhet ta njoftojë me shkrim ZRRE-në, dhe të kërkojë pëlqimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në projektin që është pjesë e aplikacionin.

SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.), të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin** të shoqërisë “Air - Energy” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA në lokacionin “Wind Park - KITKA”, për vendosjen e 9 (nëntë) turbinave secila veç e veç me kapacitet të instaluar prej 3.3 MW secila dhe 1 (një) turbinë me kapacitet të instaluar prej 2.7 MW, dhe totali i kapacitetit të instaluar prej **32.4 MW**, në ZK Hogosht, Poliçkë dhe Velegllavë e Epërmeve Komuna e Kamenicës:

- **Kontrata për Qiranë e Shfrytëzimit të Tokës së Paluejtëshme Komunale** 02 Nr. 18130 dt. 28.05.2014;
- **Pëlqimi nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës ref. KE -925/14 datë 09.10.2014**, për dhënien në shfrytëzim të pronës, për vedojen e gjeneratorëve të erës për prodhimin e energjisë elektrike, në sipërfaqe prej 00.06.00 ha ose 600.00m².
- **Kontrata për Shfrytëzimin e Tokës Pyjore ref. KE 926/14 datë 09.10.2014** e lidhur mes AKP-së dhe “Air - Energy” SH.P.K.,
- **Marrëveshja për implementimin e projektit “Parku Energjetik KITKA**, në mes të AIR ENERGY sh.p.k. dhe GURIS INSAAT VE MUHENDISLIK A.S. për ndërtim, prokurim dhe Inxhinjering.
- **Marrëveshja për Kyçe në Rrjetin e Transmisionit nr. 571, dt. 15.11.2013.** mes KOSTT sh.a. dhe “Air - Energy” SH.P.K.,
- **Pëlqimin Mjedisor - nr. 10/2097/ 2-304/ DMM** i datës 28.02.2013 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Vendimi për lëshimin e Lejes Ndërtimore – Nr. Prot. 1529-2/16 dt. 20.05.2016** për “Air - Energy” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin “Wind Park - KITKA”, ZK Hogosht, Ploçkë dhe Velegllavë e Epërmeve Komuna e Kamenicës, sipas Lejes së Ndërtimit nr. K.III-01/2016 datë. 19.05.2016 të lëshuar nga MMPH.

(Vulosur me vulën e rëndomtë të ZRRE-së më):

(Nënshkrimi (në emër të Bordit të ZRRE-së)